ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KRURGJA-26-8023-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Sulfat alumini Al2(SO4)3 · nH2O**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" Profitech " SH.P.K.**
NUI	**810081646**
Adresa	**Rr. Ilaz Kodra Nr. 5**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044784278**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Burim Vrajolli**
Adresa elektronike	**profitech.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**19.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Sulfat alumini Al2(SO4)3 · nH2O

Njoftimi për Kontratë; Data e publikuar: 23.09.2026 15:41

Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues; Data e publikuar: 28.10.2026 15:53

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 15.10.2026 13:00

Kriteri për dhënie te kontratës: Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datë 02.11.2026 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë "Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A" .

Të bashkangjitur mund të gjeni "Kërkesën për Rishqyrtim" si dhe "Vendimin" - "Pergjigjen në kërkesën për rishqyrtim" nga "Kompania Rajonale e Ujësjellësit GJAKOVA SH.A" të publikuar me datë: 09.11.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në bazë të **Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092**

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28 - Specifikimet teknike

Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazuar në "Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të datës 28.10.2026, vlerësojmë se vendimi i Komisionit Vlerësues për rekomandimin e operatorit ekonomik për kontratë është i pabazuar.

Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit është kërkuar shprehimisht që:

*"Kualiteti i kimikatit duhet të përputhet me Standardin Evropian EN 878, Tipi 1, për kimikatet e përdorura në trajtimin e ujit të destinuar për **konsum njerëzor**."*

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, rezulton se janë referuar standardet **EN 677 dhe EN 374**, dhe jo standardi i kërkuar **EN 878, Tipi 1.**

Këto standarde nuk janë ekuivalente dhe nuk dëshmojnë përmbushjen e kërkesës teknike:

- **EN 677** – ka të bëjë me kaldajat kondensuese me gaz dhe nuk ka lidhje me produktin objekt të tenderit.

- **EN 374** – është standard për dorëzat mbrojtëse kundër kimikateve dhe mikroorganizmave. Në SDS-në e dorëzuar, ky standard përmendet në kapitullin 8.2, në kuadër të rekomandimeve për pajisjet personale mbrojtëse, konkretisht për mbrojtjen e duarve.

Ndërsa **EN 878 është standardi specifik për sulfatin e aluminit që përdoret në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor**.

Rrjedhimisht, referimi në standardet EN 677 dhe EN 374 nuk përbën dëshmi të përmbushjes së kërkesës së detyrueshme për EN 878, Tipi 1, të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Theksojmë se Autoriteti Kontraktues është i obliguar të zbatojë në mënyrë të barabartë kërkesat e Dosjes së Tenderit për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në Vendimin e AK-së, përkatësisht në **Përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim të datës 09.11.2026**, kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar me arsyetimin se kërkesa për dëshmimë e përputhshmërisë me standardin EN 878, Tipi 1, nuk është pjesë e specifikimeve teknike të kërkuara nga AK-ja dhe se kjo çështje është paraparë të kompletohet me rastin e liferimit të produktit.

Një arsyetim i tillë është i pabazuar dhe nuk qëndron, pasi në **Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, pika 1**, AK-ja ka përcaktuar shprehimisht kërkesën si në vijim:

1. Kualiteti i kërkuar: Sulfati i aluminit duhet të jetë me ngjyrë të bardhë dhe me pastërti të lartë kimike, pa primesa, i përshtatshëm për procesin teknologjik të përpunimit të ujit të pijes dhe për liferim, **kualiteti i kemikatit duhet të përputhet me Standardin Evropian EN 878, Tipi 1, për kimikatet e përdorura në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor.**

Nga formulimi i mësipërm është e qartë se përputhshmëria me standardin evropian **EN 878, Tipi 1**, është kërkesë e detyrueshme e specifikimit teknik dhe, rrjedhimisht, është dashur të dëshmohet nga secili Operator Ekonomik gjatë fazës së ofertimit se produkti i ofruar përmbush këtë standard.

Sqarojmë se në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit nuk është kërkuar që përputhshmëria me standardin EN 878, Tipi 1, të dëshmohet vetëm me rastin e liferimit të produktit. Ajo që është kërkuar të dorëzohet me rastin e liferimit është *Certificate of Analysis (CoA)*, sipas pikës 3 të Aneksit 1. Ky dokument ka për qëllim të dëshmojë rezultatet e analizave dhe parametrat e produktit konkret të liferuar dhe nuk mund të konsiderohet si zëvendësim i dëshmisë për përputhshmërinë me standardin EN 878, Tipi 1.

Pra, duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet:

- Dëshmisë së përputhshmërisë së produktit me standardin EN 878, Tipi 1, e cila është pjesë e specifikimeve teknike të detyrueshme;
- Certifikatës së Analizës (CoA), e cila kërkohet të dorëzohet me rastin e liferimit të produktit, sipas pikës 3 të Aneksit 1.

Dokumentacioni i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë pas fazës së ofertimit.

Vlen të theksohet se vetë AK-ja ka bashkëngjitur dokumentacion shtesë të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë gjatë fazës së shqyrtimit të kërkesës sonë për rishqyrtim. Në këtë dokumentacion (në Specifikacionin Teknik) është bërë ndërhyrje - shtuar shënimi nga:

IMPULS-HEMIJA DOO

Bul,vojvode Stepe 54, 2100 Novi Sad, Serbia.

"Product in accordance with SPS EN878:2016 – Tip 1 and DIN EN 878".

Ky formulim nuk figuron në dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë gjatë fazës së ofertimit, por është paraqitur vetëm pas paraqitjes së kërkesës sonë për rishqyrtim.

Për më tepër, dokumenti në fjalë mban datën **12.10.2026**, ndërsa kërkesa jonë për rishqyrtim është paraqitur më **02.11.2026**. Kjo rrethanë ngre dyshime serioze lidhur me kohën e përgatitjes dhe qëllimin e këtij dokumenti, veçanërisht për faktin se ai nuk ishte pjesë e dokumentacionit të ofertës në momentin e dorëzimit të saj.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE-së së rekomanduar për kontratë, përkatësisht SDS-së, BL-së dhe Technical Specification, vërehet se përshkrimet, specifikat dhe parametrat e paraqitur janë pothuajse identike, madje 100% të përputhura me kërkesat e përcaktuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit (copy-paste).

Kjo ngre dyshime se dokumentet e paraqitura nuk janë dokumentacion teknik origjinal i prodhuesit, i cili pasqyron karakteristikat reale dhe të deklaruara të produktit të prodhuar, por dokumente të përpiluara duke u bazuar në specifikimet e kërkuara nga AK-ja, me qëllim të përshtatjes së tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Rrjedhimisht, AK-ja është dashur të vlerësojë në mënyrë objektive dhe të barabartë dokumentacionin e dorëzuar nga të gjithë Operatorët Ekonomikë, duke verifikuar nëse OE i rekomanduar për kontratë ka dëshmuar që në fazën e ofertimit përmbushjen e kërkesës së detyrueshme për standardin **EN 878, Tipi 1**, dhe jo të lejojë plotësimin apo ndryshimin e dokumentacionit pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

OE i rekomanduar për kontratë, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, **nuk ka dëshmuar se produkti i ofruar përmbush kërkesën për përputhshmëri me**

Standardin Evropian EN 878, Tipi 1, për kimikatet e përdorura në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor.

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE **"Profitech sh.p.k."**

ANULOHET Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë të publikuar me **28.10.2026**, lënda të kthehet në rivlerësim dhe më pas të shpallet fitues OE "**Profitech sh.p.k."**,

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*